

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i pergjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurës, E.K., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KPRK-së, të cilën e ka mbrojtur av. A.T. me autorizim, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 1610/17, të datës 11.09.2017, të cilin e përfaqësonte prokurori i shtetit E.A., pas mbajtjes së seancës dëgjimore më 27.01.2018, shpalli publikisht,ndërsa më 12.02.2018, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura E.K., nga babai F. dhe nëna Z., e lindur Rr., e lindur më data e lindjes... në ... me vendbanim në fshatin ... K..., studente, e papunësuar, e pamartuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa dënuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj saj.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse me datën 28.08.2017, rreth orës 14:30 minuta, në Gjilan, në rrugën “ ... ”,e pandehura nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës “ ... ” ..., ngjyrë e zezë, me tabela numri i tabelave..., ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të nenit 33.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Republikës së Kosovës, ashtu që me të arritur te udhëkryqi që lidhet me rrugën “ ... ”, nuk ndalet në shenjën e komunikacionit “Stop”, ndalim i obligueshëm dhe duke mos rrespektuar përparësinë e kalimit, me cepin e djathtë të pjesës së përparme e godet në anën e djathtë automjetin e markës “ ... ”, me tabela numri i tabelave..., të cilën e drejtonte i dëmtuari A.A., i cili ishte duke lëvizur nëpër rrugën “ ... ”, në drejtim të fshatit ..., me ç'rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari R.B., bashkëudhëtar i veturës “ ... ”, i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan – Emergjencë dhe të njejtën ditë lirohet në shtëpi.

Me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuar ligjore si dhe neneve 4, 7,41, 42, 43, 46, 73, 74, dhe 75 të KPRK-së, si dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, të pandehurës, i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurës E.K., i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 250,00 €. (dyqindë e pesëdhjetë) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nese e pandehura nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësoje dënimin me gjobë me dënimin me burgim, duke llogaritur (1) ditë burgim me 20 (njëzet) Euro gjobë.

E pandehura detyrohet që të paguajë paushallin gjyqësor ne shumë prej 20 (njëzet) Euro dhe, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

*Të dëmtuarit: A. A. nga fshati ., K.Gjilan dhe R.B. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.
Aktgjykimi u komunikua në prezencën e palëve.*

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1610/17, të datës 11.09.2017, kundër të pandehurës E.K. për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me partag.1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan më 26.09.2017 ka paraqitur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga prokurori i shtetit Esat Ademi , e pandehura E.K. dhe mbrojtësi i saj, av. A. T.

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Esat Ademi, e pandehura E.K. me mbrojtësin e saj, av. A.T. me autorizim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se kemi pranuar kërkesat për fillimin e negocimit për pranimin e fajësisë më datë 12.09.2017, pastaj prokurori i çështjes ka marrë autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDP në Gjilan, Jetish Maloku dhe kemi filluar të negociojmë me të pandehurën e sipërtheksuar si dhe mbrojtësin e saj, kështu që është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë, nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurës E.K., av. A.T., ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturën time, kemi arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi, andaj i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë, sepse e njejta është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

E pandehura E.K. në fjalën e saj deklaroi: në tërsi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratave të palëve, e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPPK-së, gjykata konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë , lidhur mes PTH-së – DP, në njërën anë, dhe të pandehurës E.K. me mbrojtësin e saj, në anën tjetër për kryerjen e veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me partag.1 të KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPK-së, vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, e që një gjë e tillë është bërë menjëherë.

Prokurori e shtetit Esat Ademi ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë marrëveshjes lëndore të nënshkrura nga palët, duke u pajtuar edhe me dënimin.

Mbrojtësi i të pandehurës E.K., av. A.T., ka deklaruar: si në fillim, por edhe tani theksoi faktin se marrëveshja është arritur në pajtim me dispozitat ligjore se dhe dakordimin e të mbrojturës time, kështu që kërkoj nga gjykata që të njejtën ta aprovoj.

E pandehura E.K., ka deklaruar: e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, pendohem për veprën e kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsëris vepra të kësaj natyre.

Pas pranimit të marrëveshjeve për pranimin të fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurën, e shpalli fajtores dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurën, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimin ashtu që të njëjtën do ta parandalojë që të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera penale dhe se ky dënim do të ketë efekt preventues edhe tek qytetarët e tjerë.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së,

Të dëmtuarit: Të dëmtuarit: A.A.nga fshati ..., K.Gjilan dhe R.B. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

***Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm
P.nr.976/17, më 12.02.2018***

***Sekretare juridike,
Rafete Syla, d.v.***

***Gj y q t a r i
Islam Thaçi, d.v.***

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.